

Tregim:

BRISKU I MYRTË BERBERIT

Në të kaluarën -tregonte Gjyshi, përveç hoxhës që e kanë paguar i gjithë katundi (katundisht) për anëtar të familjes, e kanë paguar edhe rojtarin e fushës-për hektarë që kanë pasur. Gjithashtu edhe berberin-njeriu që i ruante e i qethte meshkujt e katundit. Zanatin e berberit nuk mund ta kryente gjithsekush. Kur katundi nuk kishte zanatli të kësaj kategorie detyroheshin ta merrnin nga një katund tjetër. Berberi me një çantë dore, merrte sapunin, briskun e rrojës, gërshërët, dhe eventualisht ndonjë makinë të thjeshtë për flokë, e një herë në muaj vinte në katund, pasi nuk ishte nga i njëjti katund. Kuptohet fillimisht berberi binte dakord me parin e katundit.

E thërrisnin Myrtë Berberi. Myrta duke shkuar shtëpi më shtëpi e kryente obligimin që kishte marrë, për të cilin edhe paguhej. Mirëpo, Myrta, si Myrta ma! Sikurse edhe berberët tjerë duke pasur punë me shumë njerëz, i kishte mësuar edhe shumë fjalë, anekdota, mesele, etj. Ai kishte fituar një vetëbesim në vete. Dorën në zemër edhe ia kapte dhe i mbante mend truri, sikur tregonin. Kur donte ishte shumë zanatli dhe i përpiktë, por në momente të caktuara u bënte i mërzitshëm. Zgjaste aq shumë deri në rruajtjen apo qethjen e një personi, sa bëhej shumë i mërzitshëm. Ata që merrnin guxim ti thoin diçka, i “ndëshkonte” duke i rruajtur me brisk të vjetruar, duke iu shkaktuar dhimbje në fytyrë apo kokë. Zakonisht të moshuarit kur vinte berberi tuboheshin në grupe për të ia lehtësuar punën, por edhe për të llafosur në mes vete, e sidomos për të dëgjuar edhe meseletë e berber Myrtes, të cilat i tregonte me shumë zell. Ndoshte që ndonjëherë të ishte edhe ndonjë mysafir “nevojli”, e Myrta nuk kishte se si ta kundërshtonte, por qejfi nuk i bëhej se duhej ta qethte ose rruajtur pa pare, se ashtu ishin dakorduar me parin e katundit...

Një ditë i kishte qëlluar një mysafir, do me thanë “jo myshteri” të vetin, dhe ishte detyruar ta rregullonte, ani se nuk e kishte qejfin. Me vete mendoi, do të ia gërdisë që tjetër herë të mos të kërkojë. Berber Myrta e lagu ngadalë dhe fliste me të tjerët, kur nisi të veprojë me brisk rroje, sapuni në fytyrë ishte terur! E lagu edhe një herë, dhe të pranishmëve iu tregoi edhe një mesele të gjatë... Prapë u tha sapuni në fytyrë! E përsëriti edhe një herë, e filloi të veprojë. Tani me mysafirin nisi të bisedojë e ta pyeste. I shkreti mysafir ishte nën briskun e thyer të Myrtës, i cili ia dëmtonte lëkurën e fytyrës... Ndër të tjera e pyeti, se nga ishte, si e kishin verën atë vit. E ky përgjigjej herë saktë, herë u mundonte të ia bëjë qejfin Myrtes. Kur berberi e pyeti sa vëllezër janë. Atëherë nuk mundi të i përballojë dhimbjeve e të gënjente mysafiri, po berber Myrtës iu përgjigj:

- Deri sot jemi kanë tre vëllezër, e mas sodit nuk e di!
- Pse?, çka u bo sot! - kishte reaguar Myrta.
- Po, nëse shpëtoj unë sot nga ti e ky brisk, mbesim prapë tre, sikur po e ndiej shumë vështirë e kam me shpëtua nga ky brisk i yti. Ishte vërejtje serioze për Myrtën, të cilën e kuptoi drejtë. Më nuk foli Myrtë Berberi, por e kreu disi punën që e kishte marrë për obligim. E mysafiri kur doli nga brisku, duke iu drejtuar edhe të tjerëve të pranishëm, ofshami e tha: “pse more burra, nuk thonë të rroftë Myrta, po thonë të rroftë dreqi!” - kështu tregonte Gjyshi për rastin e Myrtes dhe mysafirit “jo myshteri” që e kishte rruar atë ditë.

Fjala e mysafirit morri dhenë, u përhap gjithë andej. Kur donin dikë me e “nëmë” thoinin: ” P’hy, terroftë Myrta!”. Kur dikush punonte ngadalë, thoinin:”po vonohesh si Myrta!”. Kur fliste dikush shumë, i thoinin: po e zgjatë si Myrtë Berberi!”, etj. etj. Ndërsa Myrtë Berberi, në fillim nuk ia vinte veshin këtyre fjalëve injoruese, por dikur iu bënë të pa durueshme, dhe hoqi dorë “vullnetarisht” nga detyra e berberit të katundit. Hapi lokalit në një qendër, por kur nuk e harroi “stilin” i të folurit gjatë veprimit të punës së berberit, deri në momentin e fundit të jetës.

Autor: *Shpat Butia*